



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER EDLIRA O. MALAJ
(GALANXHI)
ADRESA RR.SAMI FRASHERI,
PALLATI BLU PERBALLE
GJIMNAZIT PETRO NINI
LUARASI ,KATI 2
TEL: 694439947

MARRËVESHJE SIGURUESE

Nr. repertori: 1022

Nr. koleksioni: 400

Tirane më 23/03/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2023053010045926374

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

NR. 1022 REP.

NR. 400 KOL.

MARREVESHJE SIGURUESE MBI KUOTAT E SHOQERISE

Ne Tirane, sot me date 23.03 / 2023 (dy mijë e njetzet e tre), para meje noterit/es E. Golceku, anetar/e i/e Dhomës së Noterisë Tirane, me Zyre në adresën D.Y. Suterfi, u paraqiten personalisht palet:

I. **BARREMARRESI: BANKA KOMBETARE TREGTARE Sha.** -Dega Qendrore regjistruar në Regjistrin Tregtar me numer unik identifikimi të subjektit (NIPT) J62001011Q përfaqësuar nga:

Z. Elvin Vincani, i datelindjes 24/01/1978, shtetas shqiptar, mbajtes i dokumentit të identifikimit Karte identiteti nr. **034080788** dhe nr. personal **H80124123V** banues në Tirane, madhor me zotësi të plote juridike për të vepruar, në cilësinë e Drejtuesit të Degës së BKT-së "Dega Qendrore"

Znj. Majlinda Brati, i datelindjes 23/05/1985 shtetas shqiptar, mbajtes i dokumentit të identifikimit Karte identiteti nr. 037429807 dhe nr. personal **I555231140** banues në Tirane, madhor me zotësi të plote juridike për të vepruar, në cilësinë e Drejtueses së operacioneve të BKT "Dega Qendrore".

Ketu me poshte e quajtur "Banka", "BKT" ose "Barremarresi"

II. **BARREDHENESIT:**

A. "Mabco Constructions SA." një shoqëri aksionare, e krijuar dhe ekzistuese sipas legjislacionit zviceran, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me numer regjistrimi CHE 101.624.994, me seli të regjistruar në adresën: Via Cattori 7, 6902 Paradiso, Lugano, Zvicër, e përfaqësuar nga:

Z. **Valon Lluka**, shtetas shqiptar, lindur me 10.05.1975 në XKS mbajtës i pasaportës me nr. H50510285B banues në adresën Tirane madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, sipas Vendimit të Bordit të Drejtoreshë date 23.03.2023.

B. "2A Group SH.P.K." një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar dhe ekzistuese sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës, regjistruar në Regjistrin Tregtar me numer regjistrimi 810846800, me seli të regjistruar në adresën: Hyzri Talla, Qendra Tregtare Bregu i Diellit, Prishtinë, Kosovë, e përfaqësuar nga :



Z. Valon Ademi shtetas Kosovar, lindur me 11.07.1987 ne Prishtine mbajtës i pasaportes me nr. 1171934687, banues në adresën Gjilan madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e Administratorit të shoqërisë.

Ketu me poshte te quajtur bashkerisht "**Barredhenesit**" dhe secili prej tyre i quajtur vecmas "**Barredhenesi**".

Secili prej personave te lartpermendur ketu me poshte do te quhet "**Pala**" dhe bashkerisht "**Palet**".

MEQENESE

- A. Barredhenesit jane ortake te shoqerise "**Vlora International Airport - VIA**" Shpk., regjistruar ne Regjistrin Tregtar me numer unik identifikimi te subjektit (NUIS) M118090021, me seli ne adresen: Rr. Donike Kastrioti, ndertesa 4, kod i postar 1119, Njesia Bashkiake nr. 5, 1000, Tirane, me kapital 10.000 (dhjete mije) Euro te ndare ne 2 kuota ("**Shoqeria**" ose "**VIA**").
- B. Secili Barredhenes zoteron 1 kuote te kapitalit themeltar, perkatesisht ne masen 98% dhe 2% te kapitalit.
- C. Ne permbushje te kushteve paraprake te percaktuara ne Kontraten e Koncesionit, midis Bankes, Autoritetit Kontraktor dhe Koncesionarit do te nenshkruset Marreveshja e Drejtperdrejte ("**Marreveshja e Drejtperdrejte**").
- D. VIA eshte Shoqeria Koncesionare e krijuar ne perputhje me kontraten e koncesionit "Per projektimin, ndertimin, operimin, mirembajtjen dhe transferimin e Aeroportit Nderkombetar te Vlores (VIA) nga Koncesionari te AK" ("**Projekti**") te lidhur me date 20.04.2021 midis bashkimit te shoqerive "Mabco Constructions SA & YDA INSAAT SANAY VE TICARET ANONIM SIRKETI & 2A Group SH.P.K." si Koncesionari, dhe Republikes se Shqiperise se perfaqesuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjise si Autoriteti Kontraktues ("**Kontrata e Koncesionit**"). Kontrata e Koncesionit eshte miratuar nga Keshilli i Ministrave me vendimin nr. 325, date 02.06.2021 dhe ka hyre ne fuqi me publikim ne Fletoren Zyrtare nr. 89 te vitit 2021 me date 09.06.2021.
- E. Midis Bankes si kredidhenese dhe shoqerise Vlora International Airport - VIA shpk. ne cilesine e Kredimarresit eshte nenshkruar me date 23.03.2022 kontrate kredie me nr. 1020 rep. dhe nr. 338 kol., hartuar prane Noteres C. Colonna per shumen 50,000,000 Euro (50 mije e gjate milion Euro) ("**Kredia**"), siç mund te ndryshohet here pas here, ketu me poshte e quajtur "**Kontrata e Kredise**", me qellim realizimin e Projektit.
- F. Ne baze te Nenit 2.3 te Kontrates se Kredise nenshkrimi i Marreveshjes Siguruese mbi Kuotat e VIA eshte kusht paraprak i disbursimit te Kredise.
- G. Palet kane shprehur vullnetin te hyjne ne kete marreveshje me qellim sigurimin e permbushjes se detyrimeve te marra persiper nga ana e VIA ne Kontraten e Kredise dhe Dokumentet e



Garancise (me poshte “**Dokumentat e Kredise**”) ne kuadrin e financimit te Projektit, sipas kushteve dhe afateve te kesaj Marreveshje Siguruese mbi Kuotat.


Duke konsideruar sa me lart, te cilat perbejne pjese te vullnetit dhe marreveshjes se Paleve dhe do te zbatohen si pjese e pandare e kesaj Marreveshje, Palet bien dakord per sa me poshte.

I. PERKUFIZIME:

Pervec kur parashikohet ndryshe ne kete Marreveshje, ose permbajtja e saj kerkon ndryshe, shprehjet e perdorura ne Kontraten e Koncesionit dhe ne Kontraten e Kredise do te kene te njejtin kuptim ne kete Marreveshje.

Gjithashtu, shprehjet e meposhtme do te kene kuptimet e meposhtme:

- “Barra Siguruese”** ka kuptimin e parashikuar ne Nenin 2 te kesaj Marreveshje.
- “Dite Pune”** do te thote nje dite gjate se ciles bankat jane hapur per transaksione biznesi te pergjithshem ne Tirane, Shqiperi.



“Detyrime te Siguruara”

Detyrime te Siguruara do te jene:

(a) te gjitha pergjegjesite, detyrimet dhe borxhet e tashme dhe te ardhshme (qofshin absolute apo te mundshme, te lindura se bashku apo vecmas, te shprehura apo te nenkuptuara) te secilit prej Barredhenesit, Kredimarresit, Dorezanesit, ose Hipotekedhenesit per te cilat jane aktualisht ose mund te behen here pas here pergjegjes ndaj Barremarresit sipas dhe ne lidhje me Dokumentat e Kredise.

(b) te gjitha detyrimet monetare per te cilat Barredhenesi, Kredimarresi, Dorezanesi ose Hipotekedhenesi eshte, ose mund te jete ne çdo kohe dhe here pas here pergjegjes ndaj Barremarresit si pasoje direkte ose indirekte e Dokumentave te Kredise;

(c) te gjitha shumat per te cilat Barredhenesi eshte tani ose mund te jete ne çdo kohe dhe here pas here pergjegjes kundrejt Barremarresit ne baze te kesaj Marreveshjeje dhe te gjitha detyrimet e Barredhenesit sipas kesaj Marreveshjeje; dhe

(d) derisa detyrimet e permendura ne paragrafet (a), (b) dhe (c) te perkufizimit, te jene paguar pa kushtezime dhe ne menyre te parevokueshme dhe shlyer plotesisht, te gjitha detyrimet monetare te tashme ose qe mund te ekzistojne ne çdo kohe dhe here pas here si te pagueshme ose te cilesuara si te tilla nga Barredhenesi, Kredimarresi, Dorezanesi ose Hipotekedhenesi, ndaj Barremarresit, si pasoje e faktit qe pagesa e shumave te referuara ne paragrafet (a), (b) dhe (c) me siper, eshte menjanuar, revokuar apo bere e pavlefshme.

“Kapitali”

do te thote ne çdo kohe, shuma totale e shlyer plotesisht e Kuotave.

“Kolaterali”

do te thote Kuotat (te tashme dhe te ardhshme), te Drejtat e Shperndarjes dhe te Drejtat e Nenshkrimit qe i perkasin Kuotave.

“Kredimarresi”


do te thote shoqeria **“Vlora International Airport - VIA” Shpk.**, regjistruar ne Regjistrin Tregtar me numer unik identifikimi te subjektit (NUIS) M118090021.

“Kuota”

do te thote nje Kuote ne kapital.

“Ligji i Barreve Siguruese”

do te thote ligji i Republikes se Shqiperise nr. 8537, date 18.10.1999, i ndryshuar dhe siç mund te ndryshohet here pas here.



“Marreveshje”	do te thote marreveshja e siguruese mbi kuotat duke perfshire Shtojcat qe jane pjese perberese e kesaj Marreveshje.
“Marreveshje e Drejtperdrejte”	do te thote marreveshja e lidhur nga Kredimarresi. Barredhenesit (ne cilesine e ortakeve te Kredimarresit), anetaret e Bashkimit te Shoqerive pale fituese e Projektit dhe Koncesionari sipas Kontrates se Koncesionit dhe Autoriteti Kontraktor: Republika e Shqiperise e perfaqesuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjise dhe Barremarresi.
“Njoftimi i Barres Siguruese”	do te thote njoftimi per t'u bere ne Regjistrin e Barreve Siguruese.
“Njoftimi dhe Leter-kerkesa”	do te thote njoftimi dhe kerkesa qe i jepet Shoqerise siç percaktohet ne Nenin 3.1 te kesaj Marreveshje dhe bashkangjitur sipas formes se percaktuar ne Shtojcen 2.
“Njoftimi i Rastit te Ekzekutimit”	do te thote njoftimi qe jepet nga Barremarresi sipas formes bashkangjitur kesaj Marreveshje si Shtojca 3.
“Pala/Palet”	do te thote Barremarresi dhe Barredhenesit, secili prej tyre veçmas ose bashkarisht ne varesi te perdorimit dhe qellimit te dispozites perkatese.
“Periudha e Sigurimit”	Periudha e Sigurimit do te thote periudha e cila fillon ne daten e Hyrjes ne Fuqi te Kontrates se Kredise dhe perfundon ne kohen kur te gjithe Detyrimet e Siguruara permbushen ne menyre te plote, perfundimtare, te parevokueshme dhe te liruar ne menyre te patjetersueshme.
“Prokura”	do te thote prokura sipas formes dhe permbajtjes kryesisht bashkengjitur kesaj Marreveshje si Shtojca 1.
“Rast Ekzekutimi”	do te thote çdo Rast Mospërmbushje siç percaktohet ne Kontraten e Kredise.
“Regjistri i Barreve Siguruese”	ka kuptimin qe i jepet ne Ligjin mbi Barret Siguruese.
“Regjistri Tregtar”	do te thote Regjistri Tregtar i mbajtur nga Qendra Kombetare e Biznesit.
“Te Drejtat e Nenshkrimt”	do te thote te gjitha te drejtat dhe pretendimet e secilit Barredhenes per te nenshkruar dhe perftuar Kuotat si pasoje e zmadhimit te kapitalit te Kredimarresit.

“Te Drejtat e Shperndarjes”

do te thote te gjitha te drejtat, interesat dhe pretendimet financiare ne lidhje me Kuotat, perfshire por pa u kufizuar ne dividendet, shperndarjet e tjera perfshire por pa u kufizuar ne shperndarjet te cilat linden si pasoje e zvogelimit te kapitalit themeltar, pretendimet mbi te ardhurat e likuidimit si dhe te gjitha pretendimet financiare te tashme apo te ardhshme te lidhura me Kuotat.

1. Interpretimi

1.1. Ne kete Marreveshje, pervecse kur percaktohet shprehimisht ndryshe, referimit te:

- (a) Nje **“Pale”** i referohet çdo pale te kesaj Marreveshje, dhe **“Palet”** i referohet te gjithave paleve;
- (b) Nje **“person”** perfshin çdo person fizik ose juridik shqiptar apo te huaj, ortakeri, ent shteteror ose shoqeri e thjeshte, çdo organ apo autoritet te Republikes se Shqiperise dhe perfshin trashegimtarete dhe te transferuarit e autorizuar te çdo njerese prej ketyre;
- (c) Çdo Nen, paragraf ose Shtojce, me perjashtim kur shprehimisht eshte percaktuar ndryshe, i referohet Nenit, paragrafit ose Shtojces se kesaj Marreveshje;
- (d) Kjo Marreveshje ose çdo dokument tjeter, kontrate ose marreveshje, perfshin nje reference ne kete Marreveshje ose çdo dokument, kontrate ose marreveshje te ndryshuar, rregulluar apo shtuar here pas here;
- (e) Kjo Marreveshje i referohet kesaj Marreveshjeje se bashku me Shtojcat bashkengjitur saj; dhe
- (f) Çdo ligj i Republikes se Shqiperise, statut, dekret apo dispozite ligjore perfshin çdo ligj, statut, dekret ose dispozite ligjore e cila ndryshon ose zevendeson ate duke perfshire te gjitha aktet nenligjore (duke perfshire por pa u kufizuar, çdo udhezim apo vendim te ministrise apo te çdo autoriteti tjeter kompetent) miratuar ne baze te ketij ligji, statuti dekreti apo dispozite ligjore.

1.2.2 Kur konteksi e kerkon, fjalet ne numrin njejes do te pershijne dhe ato ne shumese dhe anasjelltas, dhe fjalet qe kane nje gjini do te perfshijne te gjitha gjinitete.

1.2.4 Ne rastin e nje konflikti midis dispozitave te kesaj Marreveshjeje dhe nje Shtojce te kesaj, do te kene perparesi dispozitat e kesaj Marreveshjeje mbi ato te Shtojces.

1. Titujt ne kete Marreveshje jane vetem per lehtesi referimi.

2. OBJEKTI I MARREVESHJES

2.1. Secili nga Barredhensesit krijon mbi Kolateralin nje barre siguruese te rrades se pare ne emer dhe per perfitim te Barremarresit, si garanci per permbushjen e te gjitha Detyrimeve te Siguruara. Barremarresi pranon Barren Siguruese mbi Kolateralin ne emer dhe per perfitimin te tij.

- 2.2. Kjo marreveshje hyn ne fuqi me miratimin e saj nga ana e Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise ne cilesine e Autoritetit Kontraktor nepermjet nenshkrimet te Marreveshjes se Drejtperdrejte sic referohet ne paragrafin C me siper, ne nje forme dhe permbajtje te kenaqshme per Banken dhe miratimit te vendosjes se barres siguruese nga Ministria e Financave dhe Ekonomise ("Hyrja ne Fuqi").
- 2.3. Interesat e garancise te vendosura si Kolateral ne favor te Barremarresit perfshijne te drejtat e votes lidhur me Kolateralin dhe Barredhenesit i japin Barremarresit te drejten per te perdorur te drejten e votes sipas percaktimit te Nenit 7 (Te Drejtat e Shperndarjes) dhe Nenit 8 (Te Drejtat e Votes) te kesaj Marreveshje. Palet bien dakord se te drejtat e votes lidhur me Kuotat do te ushtrohen nga Barremarresi ose Barredhenesit sipas rastit ne perputhje me parashikimet e Nenit 7 (Te Drejtat e Shperndarjes) dhe Neni 8 (Te Drejtat e Votes) te kesaj Marreveshje.
- 2.4. Deri ne kohen e ekzekutimit te Barres Siguruese, secili nga Barredhenesit do te ruaje cilesine e tij si zoterues dhe pronar i pjeses perkatese te Kolateralit.
- 2.5. Te gjitha te drejtat e Barremarresit sipas kesaj Marreveshje, te gjitha interesat e siguruara te krijuara me kete Marreveshje dhe te gjitha detyrimet e Barredhenesit do te jene absolute dhe vlefshmeria dhe ekzistenca e tyre jane te pavarura dhe autonome nga çdo ndryshim apo shtese e Kontrates se Kredise dhe te Dokumentave te Garancise dhe/ose nga çdo parashikim apo nga çdo detyrim i parashikuar dhe i rregulluar ne keto dokumenta.
- 2.6. Brenda 3 (tre) Dite Pune nga Hyrja ne Fuqi e kesaj Marreveshje, Barredhenesit do te nenshkruajne dhe do t'i dorezojne Barremarresit nje prokure qe ne thelb ka formen e percaktuar ne Shtojcen 1 (Forma e Prokures) ("**Prokura**") (e cila do te perfshije te drejten per te deleguar te drejtat dhe kompetencat e percaktuara ne te, personave te trete sipas gjykimit te Bankes), ne perfitim te Barremarresit.
- 2.7. Barra Siguruese krijohet per dhe deri ne perfundimin e Periudhes se Sigurimit. Barra Siguruese do te kete efekte te plota pavaresisht çdo garancie apo sigurimi tjeter qe mund te jete dhene apo mund te jepet ne te ardhmen ne çdo menyre nga ndonje person kundrejt Barremarresit per sigurimin e Detyrimeve te Siguruara.

3. KOMPLETIMI I BARRES SIGURUESE

3.1. Hapat specifike qe duhet te ndermerren

- 3.1.1 Brenda 2 (dy) Ditesh Pune nga Hyrja ne Fuqi e kesaj Marreveshje, Barredhenesit do te bejne te mundur qe Kredimarresi te aplikojte per regjistrimin e Barres Siguruese dhe te kesaj Marreveshje ne Regjistrin Tregtar.
- 3.1.2 Brenda dhjete (10) Ditesh Pune nga data e leshimit te çertifikates qe konfirmon regjistrimin e Barres Siguruese ne Regjistrin Tregtar, Barredhenesit do te njoftojne Barremarresin mbi regjistrimin e Barres Siguruese ne Regjistrin Tregtar.
- 3.1.3 Brenda 2 (dy) Ditesh Pune nga Hyrja ne Fuqi e kesaj Marreveshje, Barremarresi do te aplikojte per regjistrimin e Barres Siguruese dhe te kesaj Marreveshje ne Regjistrin e Barreve Siguruese

nepermjet depozitimit te Njofimit te Barres ne menyre qe Barra Siguruese te regjistrohet si barre e rradhes se pare sipas parashikimeve te ligjit shqiptar.

3.2. Hapat e tjere qe duhet te ndermerren

Pa cenuar nenin 3.1 (*Hapat specifike qe duhet te ndermerren*) Barredhenesit marrin persiper, ne menyre te parevokueshme dhe te pakushtezuar, qe sipas rastit te nenshkruajne, te dorezojne, te regjistrojne dhe te depozitojne ne (i) Regjistrin e Barreve Siguruese, dhe (ii) Regjistrin Tregtar çdo dokument per krijimin, vlefshmerine, realizimin ose perparesine, ruajtjen dhe mbrojtjen e Barres Siguruese sipas kerkesave te arsyeshme nga Barremarresi, ne nje forme dhe permbajtje te pranueshme per Barremarresin dhe ne emer e per llogari te Barremarresit do te marrin rregullisht origjinalet e nenshkruara apo kopjet e noterizuara, se bashku me çdo dokument, regjistrim, depozitim, njoftim, noterizim ose çdo deshmi tjetër te kerkuar ne baze te opinionit te arsyeshem nga Barremarresi ne menyre qe te realizoje qellimet e kesaj Marreveshje si dhe per krijimin, vlefshmerine, realizimin ose perparesine, ruajtjen dhe mbrojtjen e Barres Siguruese mbi Kolateralin.

3.3. Autorizimi; Masat Mbrojtese

Secili Barredhenes sipas kesaj Marreveshje jep miratimin e tij te shprehur se ne rast se Barredhenesit nuk permbushin ndonje nga detyrimet sipas nenit 3.1 apo nenit 3.2 brenda afateve te percaktuara, Barremarresi ka te drejten te ushtroje kompetencat si me poshte me qellim qe te pambushë çdo detyrim te Barremarresit ne perputhje me Nenin 3.1 dhe/ose Nenin 3.2:

3.3.1 te nenshkruaje çdo dokument dhe instrument dhe te kryeje çdo dhe te gjitha veprimet e nevojshme ose te arsyeshme per:

- (a) Regjistrimin e Barres Siguruese ne Regjistrin e Barreve Siguruese;
- (b) ne rast se ndonje nga Barredhenesit nuk ndermerr veprimet e nevojshme per te mbrojtur Barren Siguruese te krijuar sipas kerkeses se Barremarresit ne perputhje me Nenin 3.1 dhe/ose Nenin 3.2 brenda 2 (dy) Ditesh Pune pas marrjes se kerkeses perkatese, Barremarresi ka te drejte te kryeje çdo veprim ose akt duke vepruar ne menyre te arsyeshme dhe te pershtatshme me qellim mbrojtjen e Barres Siguruese;
- (c) te kryeje te gjitha veprimet e tjera ne lidhje me sa permendet ne Nenin 3.1 dhe 3.2 per te leshuar dhe marre deklarata, te nenshkruaje me dhe pa noterizim dhe te krijojë dokumente ne formen e nje akti noterial ose dokument ekuivalent te huaj te regjistruar nga nje noter i huaj;
- (d) te kryeje te gjitha aktet dhe veprimet e tjera dhe te nenshkruaje ose ekzekutoje dhe dorezoje çdo dokument ose te gjitha dokumentat e tjera dhe te jape çdo dhe te gjithë njoftimet qe mund te kerkohen ose te cilin Barremarresi nen diskrecionin e tij absolut dhe te plote e konsideron te nevojshem ne lidhje me transaksionet apo çeshtjet e parashikuara ne kete Nen;

3.3.2 te kryeje çdo veprim tjetër ne lidhje me sa me siper; dhe

3.3.3 te kryeje çdo veprim tjetër, i cili eshte i lejuar sipas Prokures.

4. Barra Siguruese mbi Kuotat e Ardhsme

Barredhenesit angazhohen te permbushin çdo dhe te gjitha detyrimet e percaktuara ne Nenet 3.1, 3.2 dhe 3.3 ne lidhje me Kuotat e emetuara/krijuara gjate Periudhes se Sigurimit.

5. NDODHJA E RASTIT TE EKZEKUTIMIT

1. Barredhenesit japin miratimin e tyre te shprehur qe pas ndodhjes se nje Rasti Ekzekutimi Barremarresi ka te drejte per aq sa lejohet nga legjislacioni i zbatueshem (duke perfshire te gjitha periudhat perkatese ne perputhje me nenet 35 dhe 37 te Ligjit per Barret Siguruese), pa njoftime te metejshme per Barredhenesit ose autorizim paraprak nga gjykatat, te ekzekutoje te gjitha ose çdo pjese te garancise te perbere nga Barra Siguruese, ne çdo menyre qe e gjykon te pershtatshme, duke perfshire por pa u kufizuar ne ushtrimin e çdo te drejte sipas kesaj Marreveshje.
2. Me ndodhjen e nje Rasti Ekzekutimi, Barremarresi ka te drejte, pervec sa parashikohet ne ndonje dispozite tjeter te kesaj Marreveshje:
 - (a) te bllokoje, mbledhe, realizoje, transferoje, çliroje ndaj paleve te treta, ose te disponoje Kolateralin ose çdo pjese te tij, ne menyra te tjera, ne perputhje me kushtet dhe afatet e Ligjit per Barret Siguruese; dhe mund te ngarkoje per llogari te tij dhe te paguaje shumat per shpenzimet e kryera ne lidhje me sherbimet e bllokimit, mbledhjes, realizimit, shitjes ose marrjes se pageses per Kolateralin dhe mund t'i shtoje keto shuma ne borxhin e Shoqerise dhe/ose Barredhenesve ndaj Barremarresit;
 - (b) te procedoje me ekzekutimin e pageses dhe ushtrimin e çdo te drejte dhe mjeti te Barremarresit te parashikuar nga Ligji per Barret Siguruese, si edhe çdo te drejte dhe mjet tjeter ne dispozicion te Barremarresit dhe qe nuk ndalohen nga ligji shqiptar; dhe
 - (c) t'i kerkoje Barredhenesve qe me marrjen e kerkeses se Barremarresit, te transferoje ose cedoje Kolateralin, teresisht ose pjeserisht tek çdo pale e treta.
3. Pas ndodhjes se nje Rasti Ekzekutimi, Barredhenesit japin miratimin e tyre te shprehur se Barremarresi do te kete te drejte te mbledhe dhe marre nga Kredimarresi menjehere pa ndermarre veprime te metejshme gjyqesore, pagesat e dividendeve, Te Drejtat e tjera te Shperndarjes si dhe shuma te tjera te pagueshme ne lidhje me Kuotat deri ne masen qe keto pagesa/shlyerje te te Drejtave te Shperndarjes kerkohen me qellim permbushjen e Detyrimeve te Siguruara. Pas ndodhjes se nje Rasti Ekzekutimi, Barredhenesit do te sigurojne se Kredimarresi nuk do t'i realizoje atyre pagesa te tilla qe prekin dividendet, te Drejtat e Shperndarjes ose vlera te tjera parash te kerkueshme ne lidhje me Kuotat.
4. Barredhenesit, me shpenzimet e veta do te japin dhe do te sigurojne qe dhe Kredimarresi do te jape te gjithe ndihmen dhe asistencen e nevojshme per te lehtesuar dhe realizuar ekzekutimin e Barres Siguruese.

6. PERDORIMI I TE ARDHURAVE

Te ardhurat nga ekzekutimi i Barres Siguruese do t'i paguhen Barremarresit dhe do te perdoren me qellim permbushjen e Detyrimeve te Siguruara ne perputhje me Kontraten e Kredise. Çdo e ardhur nga ekzekutimi apo shume tjeter e marre nga Barremarresi, ne tejkalim te shumes se Detyrimeve te Siguruara do t'i kaloje Barredhesisit.

7. TE DREJTAT E SHPERNDARJES

7.1 Periudha deri ne ndodhjen e Rastit te Ekzekutimit

7.1.1 Perpara ndodhjes se Rastit te Ekzekutimit secili nga Barredhesisit do te ushtroje te drejtat e votes ne lidhje me shperndarjet dhe do te udhezoje organin ekzekutiv te Kredimarresit per te disponuar te Drejtat e Shperndarjes ne çdo rast ne perputhje me kushtet e Kontrates se Kredise dhe sidomos kufizimet e percaktuara ne Kontraten e Kredise.

7.1.2 Per shmangien e çdo dyshimi, gjate Periudhes se Sigurimit, te drejtat e votes lidhur me Shperndarjet do te ushtrohen nga secili Barredhesis ne menyre te tille qe mos te merret asnje vendim apo veprim ne lidhje me funksionimin Kredimarresit i cili (i) nuk do te ishte ne perputhje me kete Marreveshje, (ii) do te ndikonte negativisht vlefshmerine apo ekzekutimin e Barres Siguruese, (iii) nuk do te ishte ne perputhje ose do te vinte ne kundershtim me parashikimet e Kontrates se Kredise, Marreveshjes se Drejtperdrejte ose (iv) do te pengonte ushtrimin e te drejtave te Barremarresit te cilat lindin nga ose ne lidhje me kete Marreveshje.

7.2. Periudha pas ndodhjes se Rastit te Ekzekutimit

Pas ndodhjes se Rastit te Ekzekutimit, Barredhesisit:

7.2.1 nuk do te kene me te drejte te marrin ose te mbajne te Drejta Shperndarje dhe secili nga Barredhesisit me ane te kesaj Marreveshje autorizon ne menyre te parevokueshme Barremarresin dhe njofton me shkrim per kete qellim Kredimarresin, qe Barremarresi te udhezoje organin ekzekutiv te Kredimarresit te mos disponoje asnje nga te Drejtat e Shperndarjes, pa miratimin paraprak me shkrim te Barremarresit; dhe

7.2.2 nese dividendet ose pagesat apo shumat e tjera te parave ne lidhje me Kuotat jane marre nga ndonje nga Barredhesisit, Barredhesisit do te mbajne keto dividende, pagesa apo shumat e tjera te parave ne mirebesim per perfitim te Barremarresit, si dhe do t'i veçojne keto dividende, pagesa apo shuma te tjera te parave nga asetet, pronat ose fondet e tjera te Barredhesisit dhe do te paguajne menjehere ose dorezojne (sipas rastit) keto dividende, pagesa dhe shuma te tjera ne favor te Barremarresit me qellim mbajtjen e tyre si garanci per permbushjen e Detyrimeve te Siguruara.

8. TE DREJTAT E VOTES

8.1. Periudha perpara ndodhjes se Rastit te Ekzekutimit

8.1.1 Perpara ndodhjes se Rastit te Ekzekutimit secili nga Barredhesisit, ka te drejte te ushtroje te gjitha te drejtat e votes lidhur me Kuotat te cilat i zoteron ne perputhje me kushtet

dhe afatet e percaktuara ne kete Marreveshje, perfshire te drejtat e votes mbi Shperndarjet, ne çdo rast sipas kushteve te parashikuara ne Kontraten e Kredise.

8.1.2 Gjate kohezgjatjes se Periudhes se Sigurimit, te drejtat e votes do te ushtrohen ne menyre te tille qe mos te merret asnje vendim i cili (i) nuk do te ishte ne perputhje me kete Marreveshje, (ii) do te ndikonte negativisht vlefshmerine apo ekzekutimin e Barres Siguruese, (iii) nuk do te ishte ne perputhje ose do te vinte ne kundershtrim me parashikimet e Kontrates se Kredise dhe te Marreveshjes se Drejtperdrejte ose (iv) do te pengonte ushtrimin e te drejtave te Barremarresit te cilat lindin nga ose ne lidhje me kete Marreveshje.

8.1.3 Veçanerisht, Barredhenesit nuk do te marrin asnje vendim ose veprime te cilat do te ndikonin Kredimarrsin te mos marre vendime ose ndermarre veprime te cilat lidhen me likuidimin, zvogelimin e kapitalit themeltar, bashkimin, ndarjen, shnderrimin, krijimin e nje shoqerie te re ose ristrukturime te tjera te Kredimarrsit pa miratimin paraprak me shkrim te Barremarresit.

8.2. Periudha pas ndodhjes se Rastit te Ekzekutimit

8.2.1 Me ane te kesaj Marreveshje secili Barredhenes jep miratimin e tij te shprehur se pas ndodhjes se nje Rasti Ekzekutimi, secili Barredhenes do te votoje sipas udhezimeve, dhe pas miratimit te Barremarresit.


9. PERFUNDIMI I TE DREJTAVE TE BARREMARRESIT

Pas perfundimit te Periudhes se Sigurimit Barra Siguruese e krijuar me ane te kesaj Marreveshje do te perfundoje dhe te gjitha te drejtat e lidhura me Kolateralin do te kalojne tek Barredhenesit. Pas perfundimit te Periudhes se Sigurimit, Barremarresi me shpenzimet e Barredhenesve do te nenshkruaje dhe do t'i dorezoje Barredheneseve te gjitha dokumentat qe Barredhenesit do te kerkojne ne menyre te arsyeshme per te provuar perfundimin e Barres Siguruese.

10. DEKLARIMET DHE GARANCITE

Pa cenuar, dhe ne vijim te deklarimeve dhe garancive te percaktuara ne Kontraten e Kredise, Barredhenesit, ne daten e kesaj Marreveshjeje, deklarojne dhe garantojne Barremarresin, si me poshte:

- (a) Nuk ekziston asnje barre mbi Kolateralin, me perjashtim te Barres Siguruese dhe te drejtat e paleve te treta te preferuara me ligj;
- (b) Barra Siguruese eshte vendosur dhe krijuar rregullisht nga secili Barredhenes dhe te gjitha detyrimet sipas kesaj Marreveshje perbejne detyrime te vlefshme dhe detyrues te Barredhenesve dhe jane ne perputhje me legjislacionin shqiptar;
- (c) Vendosja, krijimi dhe kompletimi i Barres Siguruese si dhe parashikimet e perfshira ne kete Marreveshje nuk jane ne kundershtrim me ndonje ligj shqiptar apo dokument detyrues per Barredhenesit;
- (d) Me perjashtim te garancive te krijuara sipas kesaj Marreveshje, Barredhenesit vecmas dhe se bashku, kane te drejta te plota dhe te pakufizuara ligjore si dhe jane zoteruesit e vetem dhe ligjore te Kolateralit te lire nga çdo barre siguruese apo garanci tjetere, peng



apo çdo e drejte e paleve te treta dhe nuk do t'i nenshtrohen ne te ardhmen ndonje konfiskimi, pengu apo i ndonje te drejte tjeter te paleve te treta:

- (e) Nuk ka pretendime apo procedime te cilat jane ne proces/pezull apo qe mund te paraqiten prane ndonje gjykate apo nje paneli arbitrazhi ne Republiken e Shqiperise ose jashte saj, ne lidhje me Kolateralin;
- (f) Detyrimet e Siguruara si dhe parashikimet e perfshira ne kete Marreveshje nuk jane ne kundërshtim me ndonje marreveshje apo angazhim tjeter, ku secili nga Barredhenesit eshte pale apo me ndonje dispozite te ligjit apo dokument tjeter detyrues per Barredhenesit;
- (g) Secili Barredhenes eshte nje shoqeri tregtare, e themeluar rregullisht dhe qe ekziston ne baze te legjislacionit ku eshte themeluar, me te drejta per te zoteruar asetet e saj, per te ushtruar aktivitetin e saj te biznesit dhe per te lidhur kete Marreveshje dhe ushtruar te drejtat e saj si dhe per te permbushur detyrimet e saj sipas kesaj Marreveshje dhe se ka ndermarre te gjitha veprimet e tjera te nevojshme per te autorizuar lidhjen dhe permbushjen e detyrimeve sipas kesaj Marreveshje dhe nenshkrimi dhe zbatimi i kesaj Marreveshje eshte autorizuar rregullisht nga secili prej Barredhenesve:
- (h) Lidhja e kesaj Marreveshje nga secili Barredhenes dhe permbushja e detyrimeve te tij sipas Marreveshjes nuk shkel apo bie ne kundërshtim me, apo nuk tejkalon kufijte e vendosur nga:
 - (i) çdo ligj i zbatueshem per te;
 - (ii) akti i themelimit apo statuti apo çdo dokument tjeter themelues; ose
 - (iii) çdo marreveshje apo dokument detyrues per te apo per asetet e tij apo qe perben nje rast mospermbushjeje apo perfundimi (sido qe te pershkruhet) ne baze te asaj marreveshje apo dokumenti;
- (i) te gjitha autorizimet e nevojshme dhe/ose lejet qe mundesojne dhe i japin te drejta secilit Barredhenes per te lidhur kete Marreveshje jane marre dhe jane ne fuqi dhe efekt te plote dhe do te vazhdojne te qendrojne ne fuqi dhe efekt te plote gjate gjithe periudhes se ekzistences se kesaj Marreveshje; dhe
- (j) kjo Marreveshje perben nje detyrim ligjor, te vlefshem, te detyrueshem dhe te ekzekutueshem per secilin Barredhenes dhe eshte nje sigurim efektiv mbi Kolateralin dhe mbi çdo pjese te tij ne perputhje me kete Marreveshje dhe perben nje barre siguruese te rradhes se pare te ekzekutueshme mbi Kolateralin.

11. ANGAZHIMET E BARREDHENESVE

Gjate afatit te Periudhes se Sigurimit, ose perveç rastit kur Barremarresi bie dakord ndryshe, Barredhenesit:

- (a) nuk do te ndermarrin ndonje veprim i cili:
 - (i) mund te cenoje drejtperdrejte apo terthorazi vlefshmerine, efektshmerine apo ekzekutueshmerine e Barres Siguruese apo te te drejtave dhe interesave te Barremarresit sipas Kontrates se Kredise; ose



- (ii) mund të cenojë vlefshmerinë apo ekzistencën e Kontrates së Kredise apo të drejtat e Barremarresit sipas Kontrates së Kredise.
- (b) do të ndermarrin, me shpenzimet e tyre, të gjitha veprimet që mund të jenë të nevojshme dhe në mënyrë të arsyeshme të keshillueshme për të mbrojtur vlefshmerinë, efektshmerinë dhe ekezekutueshmërinë e Barres Siguruese apo të drejtat e Barremarresit, duke përfshirë ato kundër pretendimeve të paleve të treta;
- (c) me shpenzimet e tyre do të nënshkruajnë dhe dorëzojnë menjëherë të gjitha dokumentet dhe do ndermarrin të gjitha veprimet që mund të jenë të nevojshme ose të keshillueshme me qëllim që:
 - (i) të regjistrojë, përmbushë dhe mbajë në fuqi dhe efekt të plote Barren Siguruese; dhe
 - (ii) të mundësojë ushtrimin nga ana e Barremarresit të të drejtave dhe mjeteve juridike që ai gëzon në bazë të kësaj Marreveshjeje, duke përfshirë pa u kufizuar, në ushtrimin e të gjitha të drejtave dhe mjeteve juridike të ushtrueshme me ndodhjen e një Rasti Ekzekutimi në kufijtë dhe në mënyrën e lejuar nga ligji i zbatueshëm.
- (d) të mos krijojnë apo lejojnë krijimin e ndonjë barre, interesi të siguruar apo çdo barre apo pengesë tjetër ose ekzistencën e ndonjë të drejte të paleve të treta mbi një pjesë apo mbi të gjithë asetet e ardhshme, përfshirë Kolateralin, me përjashtim të Barres Siguruese dhe interesat e siguruara të krijuara në lidhje me këtë Barre Siguruese;
- (e) të demshperblejnë Barremarresin dhe të mbajnë atë të pacenuar nga çdo dhe të gjitha kërkesat, pretendimet dhe paditë e ngritura dhe/ose të paraqitura nga palët e treta, të cilat lidhen me mbajtjen e Barres Siguruese nga Barremarresi;
- (f) të nënshkruajnë, të pranojnë dhe të dorëzojnë, detyrat, transferimet, dhe dokumente të tjera, të cilat mund të kerkohen në mënyrë të arsyeshme nga Barremarresi, me qëllim për t'i dhënë fuqi kësaj Marreveshjeje dhe të paguajë të gjitha shpenzimet për kerkimet, regjistrimet dhe depozitimet;
- (g) të dorëzojnë menjëherë tek Barremarresi të gjitha njoftimet dhe dokumentet e tjera të përfuturuar në lidhje me Kolateralin, përfshirë këtu por pa u kufizuar, pretendimet e paleve të treta; dhe
- (h) të mos shesin, transferojnë, apo ndryshe disponojnë Kolateralin përveç kur Banka jep miratimin e saj paraprak me shkrim.

12. DEMSHPERBLIMI, TAKSAT, KOSTOT DHE SHPENZIMET

12.1 Përgjegjësia për Barremarresin

Barremarresi nuk do të jetë përgjegjës për humbjet ose demet e pesuara nga Barredhënesit për shkak të ndonjë interesi sigurie të përcaktuar në këtë Marreveshjeje, të realizimit të të drejtave të Barremarresit ose ushtrimit ose pamundësisë së ushtrimit nga Barremarresi, të të drejtave, veprimeve apo mjeteve juridike, për të cilat ky i fundit ka të drejtë sipas kësaj Marreveshjeje përveç rasteve kur humbja ose dëmi është shkaktuar nga dashja apo pakujdesia e rëndë e Barremarresit.

12.2 Taksat

12.2.1 Barredhënesit do të paguajnë të gjitha taksat e pulles, regjistrimit si dhe taksat e tjera dhe çdo detyrim tjetër publik ndaj të cilave kjo Marreveshje dhe/ose garancite e parashikuara nga kjo Marreveshje janë ose mund të jenë subjekt (duke përfshirë, por pa u kufizuar në, çdo takse pulle, tarife regjistrimi në gjykatë dhe tarifa noteri, të cilat do behen të kërkueshme dhe të pagueshme në lidhje me lidhjen, regjistrimin, nënshkrimin, zbatimin dhe ekzekutimin e kësaj Marreveshje) dhe do të demshperblejnë, kohe pas kohe, Barremarresin sipas kërkesës për çdo detyrim, kosto, pretendim dhe shpenzim që mund të rezultojë për shkak të deshtimit për të paguar apo vonesës në pagesën e ndonjëres nga këto taksa.

12.2.2 Nëse këto taksa apo detyrime të tjera publike i ngarkohen Barremarresit, Barredhënesit do të kompensojnë menjëherë Barremarresin për të gjitha këto detyrime (dhe në çdo rast brenda pesë (5) Ditësh Pune) pasi të kenë marrë nga Barremarresi, kërkesën përkatëse të shoqëruar me fature ose dokument tjetër që vërteton në mënyrë të arsyeshme pagesën e kryer nga Barremarresi.

12.3. Shpenzimet e Ekzekutimit

Barredhënesit, brenda pesë (5) Ditësh Pune nga kërkesa, do t'i paguajnë Barremarresit, shumën e të gjitha kostove dhe shpenzimeve (duke përfshirë tarifën ligjore dhe noteri) të kryera nga Barremarresi në lidhje me ekzekutimin e Barres Siguruese apo ruajtjen e ndonjë prej të drejtave sipas kësaj Marreveshjeje dhe Barredhënesit do të demshperblejnë dhe do të mbajnë Barremarresin të pacenuar nga këto kosto dhe shpenzime.

12.4. Demshperblimi

Barredhënesit do të demshperblejnë menjëherë Barremarresin për çdo kosto, humbje ose detyrim të shkaktuar si rezultat i:

- (a) marrjes, mbajtjes dhe mbrojtjes së Barres Siguruese;
- (b) ushtrimit të ndonjë prej të drejtave, kompetencave, diskrecionit dhe mjeteve ligjore të Barremarresit të garantuara nga kjo Marreveshje apo nga ligji; ose
- (c) çdo vonese e Barredhënesve në përmbushjen e detyrimeve të shprehura që do të mbarten prej tij në këtë Marreveshje,

perveç kur kjo kosto, humbje apo detyrim ka ardhur si pasojë e pakujdesisë së rende apo dashjes së palës së demshperblyer.

12.5. Pagesat e pazbritshme

Te gjitha pagesat që do të kryhen ndaj Barremarresit sipas kësaj Marreveshjeje do të kryhen të lire nga dhe pa zbritje për ose në llogarinë e taksave, përveç kur Barredhënesit janë të detyruar të kryejnë këto pagesa objekt i zbritjes ose mbajtjes në burim të taksave, dhe në një rast të tillë shumën e pagueshme nga Barredhënesit në lidhje me të cilën kërkohet të behet kjo zbritje apo mbajtje në burim, do të rritet aq sa është e nevojshme për të siguruar



se, pasi te kryhet zbritja ose mbajtja ne burim, personi per llogari te te cilit si detyrim tatimor kjo zbritje ose mbajtje ne burim eshte kryer, te marre dhe te mbaje (te lire nga çdo detyrim ne lidhje me kete zbritje apo mbajtje ne burim) nje shume neto te barabarte me shumen te cilen do te kishte marre dhe per rrjedhoje mbajtur nese kjo zbritje apo mbajtje ne burim nuk do te ishte aplikuar ose nuk do te ishte kerkuar te kryhej.

Demshperblimet e parashikuara ne kete Marreveshje nuk do te cenojne te drejtat e Barremarresit sipas ndonje Dokumenti Garancie.

13. NJOFTIMET

13.1 Komunikimet me Shkrim

12.1.1 Te gjitha njoftimet apo komunikimet e tjera te kryera sipas kesaj ose ne lidhje me kete Marreveshje do te kryhen me shkrim.

13.2 Adresat

Pervec kur parashikohet ndryshe, te gjitha njoftimet dhe komunikimet e tjera sipas kesaj Marreveshje do te dergohen dorazi ose me poste rekomande, faks ose korrier te shpejte, marresve perkates ne adresen e tyre te percaktuar ne kete Marreveshje ose ne nje adrese tjeter qe do te ofrohet nga Palet per kete qellim nepermjet nje njoftimi me shkrim jo me pak se pese (5) Dite Pune, pervec kur ligji i zbatueshem parashikon ndryshe.

(a) Nese i drejtohet Barredhenesit:

“Mabco Constructions SA.” :

Via Cattori 7, 6902 Paradiso, Lugano, Zvicer Nese i drejtohet Barremarresit:

“2A Group SH.P.K.”:

Hyzri Talla, Qendra Tregtare Bregu i Diellit, Prishtine, Kosove

b) Nese i drejtohet Barremarresit:

Rruga e Vilave, Lunder I, Tirane, Kodi Postar 1045

13.3 Ditet e Pushimit

Njoftimi ose komunikimi i marre ne nje dite tjeter e cila nuk eshte Dite Pune, do te konsiderohet sikur eshte marre ne Diten vijuese te Punes.

14. LIGJI I ZBATUESHEM DHE JURIDIKSIONI

14.1 Ligji i Zbatueshem

Kjo Marreveshje do te rregullohet dhe interpretohet ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise.

14.2 Juridiksioni

15

Gjykata e Rrethit Tirane do te kete juridiksionin per zgjidhjen e mosmarreveshjeve qe mund te lindin midis Paleve ne lidhje me kete Marreveshje, ne rast se keto mosmarreveshje nuk zgjidhen ne menyre miqesore midis Paleve.

15. DISPOZITA TE NDRYSHME

15.1 Ndryshime dhe Heqje Dore

Asnje ndryshim ose heqje dore ndaj dispozitave te kesaj Marreveshje nuk do te kete efekte pervec nese eshte kryer me miratimin me shkrim te Barredhenesit dhe Barremarresit.

15.2 Modifikimi, Transferimi, Zevendesimi

Kjo Marreveshje do te jete e detyrueshme dhe do te sherbeje ne perfitim te Barremarresit pavaresisht ndonje modifikimi, ose transferimi apo zevendesimi te Kontrates se Kredise ose kesaj Marreveshje.

15.3 Interes i Vazhdueshem

Barra Siguruese e krijuar nga kjo Marreveshje do te jete detyruese per Barredhenesin, trashegimtaret e tij dhe pasardhesit e tij, dhe do te qendroje ne fuqi dhe efekt te plote, dhe do te perbeje dhe do te jete nje sigurim i vazhdueshem pavaresisht pagesave ose permbushjes se pjesshme te Detyrimeve Siguruese, apo ndryshimet ne Kontraten e Kredise, dhe nuk do te cenohet ose preket ne asnje menyre nga barre te tjera, detyrime per demshperblim ose garanci te dhena nga Barredhenesi ne perfitim te ndonje pale tjetere ose vendim apo urdher i marre nga Barremarresi ne lidhje me ndonje nga Detyrimet e Siguruara.

15.4 Kompensime te Akumuluar

Te gjitha te drejtat, veprimet dhe kompensimet e Barremarresit sipas kesaj Marreveshje i shtohen dhe nuk perjashtojne ndonje te drejte, veprim apo kompensim tjetere sipas te cilit Barremarresi gezon te drejta sipas ndonje kontrate (duke perfshire, pa u kufizuar, sipas Kontrates se Kredise) ose sipas ligjit.

15.5 Transferimi


Barredhenesi nuk do te transferoje, teresisht ose pjeserisht, ndonje prej te drejtave te tij sipas kesaj Marreveshje pa miratimin paraprak me shkrim te Barremarresit.

15.6 Interes i Siguruar i Ndare

Palet nepermjet kesaj Marreveshje pranojne shprehimisht dhe konfirmojne se Barra Siguruese eshte e ndare nga, dhe nuk lidhet me, ndonje interes tjetere te siguruar qe i eshte dhene ose do t'i jepet Barremarresit nga Barredhenesi per te siguruar permbushjen e detyrimeve te Barredhenesit sipas Kontrates se Kredise. Palet ne kete Marreveshje bien dakord qe Barremarresi mund te ushtroje te drejtat e saj sipas kesaj Marreveshjeje, pavaresisht te drejtave te saj sipas ndonje interesi tjetere te siguruar qe siguron permbushjen e detyrimeve te Barredhenesit sipas Kontrates se Kredise.

15.7 Ndashmeria e Dispozitave

Dispozitat qe pemban çdo nen dhe paragraf i kesaj Marreveshje do te jene te zbatueshme ne menyre te pavarur nga njera tjetra dhe vlefshmeria e tyre nuk do te cenohet nese ndonje dispozite tjetere eshte e pavlefshme. Nese ndonje nga dispozitat eshte e pavlefshme por do te kishte qene e vlefshme nese ndonje pjese e dispozites do te fshihej, dispozita ne fjale do te aplikohet me modifikimet e nevojshme qe e bejne ate te vlefshme.



Kjo marreveshje eshte pjese e Kontrates se Kredise dhe e detyrueshme si per palet nenshkruese, ashtu dhe per personat qe mund te zene vendin e tyre ose te cileve u jane transferuar te drejtat apo detyrimet.

15.8 **Kopje**

Kjo Marreveshje eshte hartuar ne 4 kopje origjinale ne giuhen shqipe, secila me vlere te njejte.

Une, i nenshkruari Noteri, u lexova Paleve sa me sipër dhe u shpjegova atyre efektet ligjore te çdo dispozite te kesaj Marreveshje.

Palet ne kete Marreveshje, me deklarojne se e kane kuptuar permbajtjen e ketij dokumenti dhe konfirmojne qe kjo permbajtje perputhet plotesisht me deklarimet dhe kuptimet e tyre dhe ato me vullnet te plote synojne ekzaktesisht ato efekte ligjore. Palet konfirmojne vullnetin e tyre te lire ne pranimin dhe bien dakord per sa mesiper duke nenshkruar rregullisht kete Marreveshje ne pranine time.

Une, Noteri, vertetoj gjithë sa me sipër duke nenshkruar dhe vulosur te njejtin dokument.

PALET

"Mabco Constructions SA."

Perfaqesuar nga: Z. Valon Luluka

Valon Luluka
Mabco Constructions SA
Via Galloni 7
CH - 6902 Lugano-Paradiso

"2A Group SH.P.K."

Perfaqesuar nga: Z. Valon Ademi

Valon Ademi



BANKA KOMBETARE TREGTARESHE

Perfaqesuar nga:

Z. Elvin Vincani

Elvin Vincani
Znj. Majlinda Brati

Majlinda Brati

Edlira Malaj
EDLIRA MALAJ (GALINXHO)
NIPR L31322000A
TEL: 042 451044



SHTOJCA I
FORMATI I PROKURES
Prokure e Posaçme

Per t'u vendosur ne formen e aktit noterial – me poshte eshte vetem permbajtja

[...]

Nepermjet ketij akti, jep ne menyre te parevokueshme kete prokure per:

[...] ("**Banka**")

(perkufizim i cili do te perfshije çdo zevendesues ose perfaqesues tjetër te caktuar sipas kesaj prokure) si perfaqesuesin e Shoqerise duke e autorizuar qe ne emer e per llogari te saj:

1. Te kryeje çdo dhe te gjitha veprimet e nevojshme ose ne menyre te arsyeshme te keshillueshme per te depozituar Njoftimin e Barres Siguruese (sipas percaktimit ne Marreveshjen Siguruese mbi Kuotat date [...] te lidhur ndermjet Banka Kombetare Tregtare Sha. si **Barremarres** dhe Mabco Constructions SA e 2A Group SH.P.K. se bashku quajtur **Barredhenesit** dhe veçmas quajtur **Barredhenesi** nepermjet se ciles Barredhenesit vendosin barre siguruese te rradhes se pare mbi Kuotat, te Drejtat e Nenshkrimit, te Drejtat e Shperndarjes (sipas perkufizimeve ne kete marreveshje) te tashme apo te ardhshme ("**Kolaterali**") te zoteruara nga Barredhenesit ne kapitalin e shoqerise Vlora International Airport – VIA Shpk., nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, regjistruar ne Regjistrin Tregtar me numer unik identifikimi te subjektit (NUIS) M118090021, ("**Shoqeria**") ne favor te Bankes ("**Marreveshja**") dhe/ose te regjistroje Barren Siguruese (sipas percaktimit ne Marreveshje);
2. Te kryeje çdo veprim qe e konsideron te pershtatshem dhe te nevojshem me qellim mbrojtjen e Barres Siguruese ne favor te Bankes;
3. Te njoftoje dhe t'i kerkoje Regjistrin Tregtar te regjistroje Barren Siguruese (duke perfshire te drejten per te kryer çdo veprim, perfshire edhe paraqitjen e çdo kerkese, dokumenti apo te ngjashem per kete qellim).

Kjo Prokure rregullohet nga legjislacioni shqiptar.

Perveç kur konteksti e kerkon ndryshe, termat e perdorur ne kete Prokure dhe qe nuk perkufizohen ndryshe, kane kuptimin qe u eshte dhene ne Marreveshje.

Shoqeria ratifikon dhe konfirmon te gjitha dokumentet, aktet dhe veprimet qe Banka do te realizoje ose kryeje ne ushtrim te rregullt te ndonje prej kompetencave te dhena ose qe supozohet se i jane dhene asaj nepermjet kesaj Prokure.

Autoriteti i dhene Bankes nga kjo Prokure do te perfundoje me perfundimin e Periudhes se Sigurimit.

PALET

SHTOJCA 2
FORMA NJOFTIMIT DHE LETRA KERKESES

Per: **Kredimarresin**

Rr. Donike Kastrioti, ndertesa 4, kodi postar 1119, Njesia Bashkiake nr. 5, Tirane 1000

Ne vemendje te: **Barredhenesve**

Mabco Constructions SA. :

Via Cattori 7. 6902 Paradiso. Lugano. Zvicer Nese i drejtohet Barremarresit:

“2A Group SH.P.K.”:

Hyzri Talla. Qendra Tregtare Bregu i Diellit, Prishtine. Kosove

I referohemi Marreveshjes Siguruese mbi Kuotat date __. __. 2023 (“**Marreveshja**”) te lidhur midis shoqerive Mabco Constructions SA, 2A Group SH.P.K. si **Barredhenesit** dhe Bankes Kombetare Tregtare si **Barremarresi** (“**Marreveshja**”). Fjalet me shkronja te medha te perdorura ne kete Leter do te kene te njejtin kuptim sipas Marreveshjes Siguruese mbi Kuotat.

Me ane te ketij Njoftimi dhe Leter Kerkese, kerkojme qe te regjistrohet Barra Siguruese mbi Kuotat ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Biznesit.

Nderime.

(Banka)

Nga:

Pozicioni:

Nenshkrimi:



SHTOJCA 3
NJOFTIMIT I RASTIT TE EKZEKUTIMIT

Per; **Barredhesisit**

Mabco Constructions SA. :

Via Cattori 7, 6902 Paradiso, Lugano, Zvicer Nese i drejtohet Barremarresit:

2A Group SH.P.K.”:

Hyzri Talla. Qendra Tregtare Bregu i Diellit, Prishtine, Kosove

Ne vemendje te: **Kredimarresit**

Rr. Donike Kastrioti, ndertesa 4, kodi postar 1119, Njesia Bashkiake nr. 5. Tirane 1000

I referohemi Marreveshjes Siguruese mbi Kuotat date ___/___/2023 (“**Marreveshja**”) te lidhur midis shoqerive Mabco Constructions SA, YDA INSAAT SANAY VE TICARET ANONIM SIRKETI dhe 2A Group SH.P.K. si **Barredhesisit** dhe Bankes Kombetare Tregtare Sha. si **Barremarresi** (“**Marreveshja**”). Fjalet me shkronja te medha te perdorura ne kete Leter do te kene te njejtin kuptim sipas Marreveshjes Siguruese mbi Kuotat.

Me ane te kesaj Letre ju njoftojme se ka ndodhur nje Rast Ekzekutimi. Banka ka ndjekur te gjitha procedurat e parashikuara ne Kontraten e Kredise per te kerkuar ekzekutimin e Barres Siguruese dhe kjo leter perben Njoftimin e Rastit te Ekzekutimit.

Ne perputhje me Nenin 7.2 (*Periudha pas Ndodhjes se Rastit te Ekzekutimit*) te Marreveshjes, pagesa e dividendeve, te Drejtat e tjera te Spherndarjes si dhe shumat e tjera te parave te paguara ose te kerkueshme ne lidhje me Kuotat e Barredhesisve do te kryhen sipas te dhenave me poshte:

[.....]

Nderime,

Banka Kombetare Tregtare Sha

Nga:

Pozicioni:

Nenshkrimi:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER EDLIRA O. MALAJ
(GALANXHI)
ADRESA RR.SAMI FRASHERI,
PALLATI BLU PERBALLE
GJIMNAZIT PETRO NINI
LUARASI ,KATI 2
TEL: 694439947

VËRTETIM NËNSHKRIMI

(VËRTETIM NËNSHKRIMI I MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME)

Nr. repertori: 1019

Tirane më 23/03/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2023053010064714260

VENDIM
I
KUVENDIT TË AKSIONARËVE
TË
2A GROUP SH.P.K.

Sot, më datë 09/03/2023, në përputhje me Statutin e Shoqërisë 2A Group Sh.P.K., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar dhe që ekziston sipas legjislacionit kosovar, regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, me numër unik identifikues 810846800, me seli të regjistruar në Rruga Ali Pashë Tepelena, Nr. 1/14 IVY Residence, 10000 Prishtinë, Kosovë, ("Shoqëria"), është thirrur Mbledhja e Kuvendit të Aksionarëve duke qenë prezent Aksionari i cili përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, si më poshtë:

Valon Ademi i lindur më 11.07.1987, në Kosovë rezident në Prishtinë, Kosovë, mbajtës i pasaportes me numer P00505522 dhe numer personal 1171934687 i cili zotëron një (1) kuotë që përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

Kuvendi i Aksionarëve

DUKE marrë në konsideratë se:

- Aksionari është njoftuar në mënyrë të rregullt në lidhje me çështjet që do të vendosen nga ky vendim i shkruar;
- Kuvendi i Aksionarëve do të vendosë për çështjet e mëposhtme në përputhje me Statutin e Shoqërisë;
- Nënshkruarsi i këtij Vendimi ka autoritetin dhe fuqinë e nevojshme për të nënshkruar dhe lëshuar këtë Vendim me shkrim në emër të Kuvendit të Aksionarëve

Kuvendi me votë unanime që përfaqëson 100% të të drejtave të votimit në Kuvendit të Aksionarëve e, bazuar në dispozitat e Statutit të Shoqërisë dhe Ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, vendos si më poshtë

VENDOSI:

1. Të miratojë lidhjen dhe zbatimin e (a) Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë që do të lidhet ndërmjet Shoqërisë dhe subjekteve (i) "VLORA INTERNATIONAL AIRPORT – VIA" SH.P.K. ("VIA"), shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar dhe ekzistuese sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë, me numër unik identifikues NUIS M118090021 si "Shoqëria Koncesionare/Huamarresi", (ii) Banka Kombëtare Tregtare sh.a. një shoqëri aksionare, e regjistruar pranë Regjistrin Tregtar shqiptar me numer unik identifikues (NIPT) J620001011Q ("BKT") si "Kredithenes", (iii) Ministria e Infrastrukturs dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë si "Autoriteti Kontraktues" dhe (iv) shoqërisë Mabco Constructions SA, një shoqëri aksionare, e krijuar dhe ekzistuese sipas legjislacionit zviceran, regjistruar në Regjistrin Tregtar me numer regjistrimi CHE-101.624.994, me seli të regjistruar në adresën: Rr. Via Cattori 7, 6903 Paradiso, Lugano, Zvicër; dhe (b) Marrëveshjes së Barres Siguruese mbi Kuotat e cila do të lidhet ndërmjet Shoqërisë dhe Mabco Constructions SA si "Barredhenes" dhe BKT si "Barremarres" me qëllim vendosjen e barres siguruese mbi kuotat e shoqërisë VIA për garantimin e detyrimeve sipas kontratës së kredisë që VIA në cilësinë e Kredimarrësit do të lidhe me BKT ("Kontrata e Kredisë" për kredinë në shumën 56,000,000.00 Euro (pesedhjetë e gjashtë milion Euro) ("Kredia"), për realizimin e investimeve gjate fazes së ndërtimit të Projektit të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës në përputhje me kontratën e koncesionit/PPP "Për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës".
- VIA
2. Shoqëria të zbatojë në përpikëri të gjitha të drejtat dhe detyrimet që dalin nga marrëveshjet e lartçekura dhe të cilat kanë si qëllim sigurimin e përmbushjes së detyrimeve të marra përsiper nga ana e VIA me Kontraten e Kredisë dhe dokumentet e tjera financiare të lidhura në kuadrin e financimit të aktiviteteve të ndërtimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës në përputhje me kontratën e koncesionit/PPP "Për projektimin, ndërtimin, operimin,

mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës të lidhur midis bashkimit të shoqërive Mabco Constructions SA, YDA INSAAT SANAYI VE TICARET ANONIM SIRKETI dhe 2A GROUP Sh.p.k., si "Ofertuesit" dhe Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë.

3. Shoqëria merr përsipër dhe garanton me të gjitha pasuritë e saj detyrimet e VIA që dalin nga tërësia e dokumenteve financiare të lidhura në kuadrin e financimit të aktivitetit të ndërtimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës kundrejt BKT. Autorizohet drejtori i Shoqërisë Z. Valon Ademi të nënshkruajë kontratën/marrëveshjen e dorezanisë me BKT dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm me qëllim garantimin e detyrimeve të VIA kundrejt BKT sipas Kontrates së Kredisë dhe dokumentave të lidhur me të.
4. T'i japë të drejtën, autorizojë dhe kërkojë drejtorit të Shoqërisë Z. Valon Ademi, të kryejë të gjitha veprimet për nënshkrimin e marrëveshjeve sipas pikave 1 deri 3 të këtij Vendimi dhe dokumenteve të tjera të kërkuara si dhe përfaqësimin para palëve të treta private ose publike si dhe kryerjen e veprime të tjera që nuk parashikohen shprehimisht ketu, e të cilat do të jenë të nevojshme për formalizimin e marrëveshjeve të lartëcekura.
5. Autorizohet Drejtori i Shoqërisë Z. Valon Ademi, të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortave të shoqërisë "VLORA INTERNATIONAL AIRPORT - VIA" SH.P.K. shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar dhe ekzistuese sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë, me numër unik identifikues NUTS MI 18090021, për të vendosur në lidhje me rendin e dites si me poshte:
 - i. Miratimi për lidhjen dhe zbatimin e: (i) Kontrates së Kredisë; (ii) Marrëveshjes së Bashkëpunimit, (iii) Marrëveshjes së Barres Siguruese mbi të ardhurat e Arketueshme; dhe (iv) Marrëveshjes së Drejtëpërdrejtë, me subjektin tregtar **Banka Kombëtare Tregtare sh.a.** një shoqëri aksionare, regjistruar pranë Regjistrin Tregtar me numër unik identifikues të subjektit (NIPT) J62001011Q;
 - ii. Miratimi për zbatimin me përpikmëri të të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që dalin nga marrëveshjet e lartëcekura dhe që kanë për qëllim financimin e aktiviteteve të ndërtimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës në përputhje me kontratën e koncesionit/PPP "Për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës të lidhur midis bashkimit të shoqërive Mabco Constructions SA, YDA INSAAT SANAYI VE TICARET ANONIM SIRKETI dhe 2A GROUP Sh.p.k., si "Ofertuesit" dhe Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjisë ("Autoriteti Kontraktor");
 - iii. Autorizimi i Z. Valon Lluka, duke përfshirë, sipas rastit, si përfaqësues i disa palëve (Doppel-/Mehrfachvertretung) dhe vetë-kontraktimi (Selbstkontrahieren), të kryejë të gjitha veprimet për nënshkrimin e marrëveshjeve sipas pikës i) të këtij Vendimi në emër dhe për llogari të VLORA INTERNATIONAL AIRPORT - VIA Sh.P.K. dhe dokumenteve të tjera të kërkuara si dhe përfaqësimin para palëve të treta private ose publike si dhe kryerjen e veprime të tjera që nuk parashikohen shprehimisht ketu, e të cilat do të jenë të nevojshme për formalizimin e marrëveshjeve të lartëcekura dhe për hyrjen e tyre në fuqi.
 - iv. Ratifikimi i veprimeve të Z. Valon Lluka në lidhje me themelimin e VLORA INTERNATIONAL AIRPORT - VIA Sh.P.K.;
 - v. Ratifikimin e veprimeve të Z. Valon Lluka si përfaqësues i VLORA INTERNATIONAL AIRPORT - VIA Sh.P.K. që nga nënshkrimi i Kontrates së Koncesionit e deri në datën e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
7. Duke qenë se nuk u ngritën çështje të tjera për diskutim, takimi u shpall i mbyllur.

Për llogari të:
2A Group SH.P.K.

Aksionari
Valon Ademi





REPUBLIKA E KOSOVËS

NOTER

SINAN VISOKA

PODUJEVË

LRP. NR.3228/2023

Unë Sinan Visoka – Noter në Podujevë rr. Dr. Bajram Krasniqi p.nr., Podujevë

VËRTETOJ SE nënshkrimi i vënë në aktin :

VENDIM i përpiluar dhe nënshkruar nga pala:

2 A GROUP " SH.P.K., me seli në Hyzri Talla Qendra Tregtare Bregu i Diellit - Prishtinë, e regjistruar në Agjencinë për Regjistrim të Biznesit me numër unik identifikues **810846800**, e cila përfaqësohet nga pronari **z. VALON ADEMI** i lindur në Prishtinë, me datë 11/07/1987 (njëmbëdhjetë korrik njëmijë e nëntëqinde tetëdhjetë e shtatë), shtetas kosovar, identiteti i të cilit konstatohet nga letërnjoftimi me nr.personal 1171934687, lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës, me datë 24.07.2014 valid deri me datë 23.07.2024 me zotësi të plotë për të vepruar.

Akti **VENDIM** i është nënshkruar para meje në selinë e zyrës sime nga pala – personalisht, ndërsa është hartuar jashtë zyrës sime.

Noteri vërteton se nënshkrimi i palëve është i vërtet dhe është nënshkruar në prezencën time.

Bazuar në Ligjin mbi Noterinë, Noteri nuk përgjigjet për përmbajtjen e këtij dokumenti.

Shpërblimi për punën e Noterit është llogaritur 1€ plus TVSH 18% + 1 kopje në bazë të numrit tarifor 8 dhe është në shumë sipas tarifës së noterëve, është përpiluar në Podujevë më 09 mars 2023.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER EDLIRA O. MALAJ(GALANXHI)



V2023053010064714260

DATE 23/03/2023
NR REP 1019

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 23.03.2023, para meje Notere EDLIRA O. MALAJ(GALANXHI), anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, RR.SAMI FRASHERI, PALLATI BLU PERBALLE GJIMNAZIT PETRO NINI LUARASI ,KATI 2, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUESIT:

Valon Ademi, atësia Imer, amësia Fatime, shtetas Kosovar, lindur në PRISHTINE dhe banues në PRISHTINE, me adresë Bregu I Diellit, lindur më 11/07/1987, gjendja civile, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim nr. personal 1171934687, *ne cilesine e aksionarit i cili perfaqeson 100 % te kapitalit te regjistruar te shoqerise Shoqëria 2A GROUP SHPK.*

Subjekti i mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noteres, Vendim i Kuvendit të Aksionareve të 2A Group SHPK, datë 09.03.2023 “, bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma “ë”, si dhe nenin 128 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

EDLIRA O. MALAJ(GALANXHI)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER EDLIRA O. MALAJ
(GALANXHI)
ADRESA RR.SAMI FRASHERI,
PALLATI BLU PERBALLE
GJIMNAZIT PETRO NINI
LUARASI ,KATI 2
TEL: 694439947

VËRTETIM NËNSHKRIMI

(VËRTETIM NËNSHKRIMI I MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME)

Nr. repertori: 1018

Tirane më 23/03/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2023053010064670496

<p style="text-align: center;">VENDIMI</p> <p style="text-align: center;">I</p> <p style="text-align: center;">BORDIT TË DREJTORËVE</p> <p style="text-align: center;">TË</p> <p style="text-align: center;">MABCO CONSTRUCTIONS SA</p>	<p style="text-align: center;">RESOLUTION</p> <p style="text-align: center;">OF THE</p> <p style="text-align: center;">BOARD OF DIRECTORS</p> <p style="text-align: center;">OF</p> <p style="text-align: center;">MABCO CONSTRUCTIONS SA</p>
<p>Sot, më datë <u>17/03/2023</u>, në përputhje me Statutin e Shoqërisë Mabco Constructions SA, një shoqëri aksionare, e krijuar dhe ekzistuese sipas legjislacionit zviceran, regjistruar ne Regjistrin Tregtar me numer regjistrimi CHE-101.624.994, me seli të regjistruar në adresën: Rr. Via Cattori 7, 6902 Paradiso, Lugano, Zvicër ("Shoqëria"), është thirrur një takim i Bordit të Drejtorëve, me prezencën e drejtorëve si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Emin Pacolli; 2. Agim Pacolli; 3. Habibe Bunjaku. <p style="text-align: center;"><u>Bordi i Drejtorëve</u></p> <p>DUKE marrë në konsideratë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Anëtarët e bordit të drejtorëve janë njoftuar në mënyrë të rregullt në lidhje me çështjen që do të vendoset nga ky vendim i shkruar; • Bordi i Drejtorëve do të vendosë për çështjen e mëposhtme në përputhje me Statutin e Shoqërisë; • Nënshkruesi i këtij Vendimi ka autoritetin dhe fuqinë e nevojshme për të nënshkruar dhe lëshuar këtë Vendim me shkrim në emër të Bordit të Drejtorëve; • Marrëveshjet dhe aktet e referuara në këtë vendim i janë paraqitur Bordit të Drejtorëve dhe është vendosur që lidhja e këtyre marrëveshjeve është në interesin më të mirë të Shoqërisë dhe janë në përputhje me parimin e tregut. 	<p>Today, on <u>17/03/2023</u>, in accordance with the Bylaws of Mabco Constructions SA, a joint-stock company, established and existing under Swiss legislation, registered in the Commercial Register with registration number CHE-101.624.994, with registered office in address: St. Via Cattori 7, 6902 Paradiso, Lugano, Switzerland (the "Company"), the Board of Directors meeting has been convened, with the presence of the following directors:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Emin Pacolli; 2. Agim Pacolli; 3. Habibe Bunjaku. <p style="text-align: center;"><u>Board of Directors</u></p> <p>CONSIDERING that:</p> <ul style="list-style-type: none"> • The members of the Board of Directors have been notified in a regular manner regarding the matter to be decided by this written decision; • The Board of Directors will decide on the following issue in accordance with the Company's Bylaws; • The signatory of this Resolution has the necessary authority and power to sign and issue this Resolution in writing on behalf of the Board of Directors. • The agreements and acts referred to in the present resolution have been presented to the Board of Directors and that it has been resolved that the entering into said agreements is in the best interest of the Company and are at arm's length;

Atëherë, Bordi i Drejtorëve me votim unanim vendosi:

1. Të miratojë lidhjen dhe zbatimin nga ana e Shoqërisë të marreveshjeve të mëposhtme:

(i) Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë që do të lidhet ndërmjet Shoqërisë dhe subjekteve "VLORA INTERNATIONAL AIRPORT - VIA" SH.P.K. ("VIA"), shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar dhe ekzistuese sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë, me numër unik identifikues NUIS M118090021 si "Shoqëria Koncesionare / Huamarrësi". Banka Kombëtare Tregtare sh.a. një shoqëri aksionare, e regjistruar pranë Regjistrin Tregtar shqiptar me numër unik identifikues (NIPT) J620001011Q ("BKT") si "Kredidhenesi". Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë si "Autoriteti Kontraktues" dhe shoqëria 2A Group Shpk.

(ii) Marrëveshjes së Barres Siguruese mbi Kuotat e cila do të lidhet ndërmjet Shoqërisë dhe 2A Group SH.P.K. si "Barredhenesi" dhe BKT si "Barremarrësi" me qëllim vendosjen e barres siguruese mbi kuotat e shoqërisë VIA për garantimin e detyrimeve sipas kontratës së kredisë që VIA në cilësinë e Kredimarrësit do të lidhe me BKT ("Kontrata e Kredisë") për kredinë në shumën **56,000,000.00 Euro** (pesëdhjetë e gjashtë milion Euro) ("Kredia"), për realizimin e investimeve gjatë fazës së ndërtimit të Projektit të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës në përputhje me kontratën e koncesionit/PPP "Për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës" dhe

Therefore, the Board of Directors by unanimous vote decides as follows:

1. To approve the conclusion and implementation of the following agreements:


(i) the Direct Agreement that will be concluded between the Company and the entities "VLORA INTERNATIONAL AIRPORT - VIA" SH.P.K. ("VIA"), a limited liability company, established and existing according to Albanian legislation, registered in the Commercial Register of Albania, with unique identification number NUIS M118090021 as "Concessionaire / Borrower" Banka Kombëtare Tregtare sh.a. a joint stock company, registered with the Albanian Trade Register with unique identification number (NIPT) J620001011Q ("BKT") as "Creditor", the Ministry of Infrastructure and Energy of the Republic of Albania as "Contracting Authority" and the company 2A Group Shpk;

(ii) the Securing Charge Agreement on Quotas which will be concluded between the Company and 2A Group SH.P.K. as "Chargor" and BKT as "Chargee" for the purpose of placing a securing charge on the quotas of VIA company to guarantee the obligations under the loan agreement that VIA, as the Borrower, will conclude with BKT ("Loan Agreement") for the loan in the amount 56,000,000.00 Euros (fifty-six million Euros) ("Loan"), for the realization of investments during the construction phase of the Vlorë International Airport Project in accordance with the concession contract/PPP "For the design, construction, operation, maintenance and transfer of Vlorë International Airport" and

<p>(iii) Marrëveshjes së Garancisë me Kërkesë të Parë në shumën maksimale prej 72.000.000 Euro (shtatëdhjetë e dy milion euro) në favor të BKT.</p>	<p>(iii) the First Demand Guarantee Agreement in a maximum amount of EUR 72,000,000 (seventy-two million Euros) to the benefit of BKT.</p>
<p>2. Shoqëria të zbatojë me përpikmëri të gjitha të drejtat dhe detyrimet që dalin nga marrëveshjet e lartëcekura dhe të cilat kanë si qëllim sigurimin e përmbushjes së detyrimeve të marra përsiper nga ana e VIA me Kontraten e Kredise dhe dokumentet e tjera financiare të lidhura në kuadrin e financimit të aktiviteteve të ndërtimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës në përputhje me kontratën e koncesionit/PPP "Për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës të lidhur midis bashkimit të shoqërive Mabco Constructions SA, YDA INSAAT SANAYI VE TICARET ANONIM SIRKETI dhe 2A GROUP Sh.p.k., si "Ofertuesit" dhe Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>2. The Company must strictly implement all the rights and obligations that arise from the above-mentioned agreements and which are aimed at ensuring the fulfillment of the obligations assumed by VIA with the Loan Agreement and other financial documents related to the framework of financing the construction activities of Vlorë International Airport in accordance with the concession contract/PPP "For the design, construction, operation, maintenance and transfer of Vlorë International Airport connected between the merger of companies Mabco Constructions SA, YDA INSAAT SANAYI VE TICARET ANONIM SIRKETI and 2A GROUP Sh.p.k., as "Bidders" and the Ministry of Infrastructure and Energy of the Republic of Albania.</p>
<p>Shoqëria merr përsipër dhe garanton me të gjitha pasuritë e saj detyrimet e VIA që dalin nga tërësia e dokumenteve financiare të lidhura në kuadrin e financimit të aktivitetit të ndërtimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës kundrejt BKT.</p>	<p>The Company undertakes and guarantees with all its assets the obligations of VIA arising from the set of financial documents related to the financing of the Vlorë International Airport construction activity vis-à-vis BKT.</p>
<p>3. Përveç të drejtës së njëjtë të secilit dhe çdo anëtar i Bordit, t'i jape të drejtën, autorizojë dhe kërkojë Z. Valon Lluka, duke përfshirë, sipas rastit, si përfaqësues i disa palëve (Doppel-/Mehrfachvertretung) dhe vetë-kontraktimi (Selbstkontrahieren), të kryejë të gjitha veprimet për nënshkrimin e marrëveshjeve sipas pikës 1 të këtij Vendimi dhe dokumenteve të tjera të kërkuara si dhe përfaqësimin para palëve të treta private ose publike si dhe kryerjen e veprimit të tjera që nuk parashikohen shprehimisht këtu, e të cilat do të jenë të nevojshme për formalizimin e marrëveshjeve të lartëcekura.</p>	<p>3. Besides the same right of any and each Board member, to give the right, authorize and request from Mr. Valon Lluka, including, as the case may be, as representative of several parties (Doppel-/Mehrfachvertretung) and self-dealing (Selbstkontrahieren), to perform all actions for signing agreements according to point 1 of this Resolution and other required documents as well as representation before private or public third parties as well as performing other actions that are not expressly provided for here, and which will be necessary for the formalization of the aforementioned agreements.</p>
<p>4. Autorizohet Kryetari i Bordit të Drejtoreve të Shoqërisë Z. Emin Pacolli, i lindur më 01.06.1972, në Marec, rezident në Pambio Noranco, mbajtës i</p>	<p>4. The Chairman of the Board of Directors of the Company, Mr. Emin Pacolli, born on 01.06.1972, in Marec, resident in Pambio Noranco, holder of</p>

pasaportes me numër X4316021, të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve të shoqërisë VIA shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar dhe ekzistuese sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë, me numër unik identifikues NUIS M118090021, ku Shoqëria zoteron 98% të kapitalit të saj, për të vendosur në lidhje me rendin e dritës si më poshtë:

- i. Miratimi për lidhjen dhe zbatimin e: (i) Kontrates së Kredisë; (ii) Marrëveshjes së Bashkëpunimit, (iii) Marrëveshjes së Barres Sigurorese mbi të ardhurat e Arketueshme dhe (iv) Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë, të cilat do të lidhen (nder të tjera) ndërmjet VIA dhe shoqërisë **Banka Kombëtare Tregtare sh.a.** një shoqëri aksionare, regjistruar pranë Regjistrin Tregtar me numër unik identifikues të subjektit (NIPT) J62001011Q;



Miratimi për zbatimin në përpikmëri të të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që dalin nga marrëveshjet e lartëcekura dhe që kanë për qëllim financimin e aktiviteteve të ndërtimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës në përputhje me kontratën e koncesionit/PPP "Për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës të lidhur midis bashkimit të shoqërive Mabco Constructions SA, YDA INSAAT SANAYI VE TICARET ANONIM SIRKETI dhe 2A GROUP Sh.p.k., si "Ofertuesit" dhe Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjisë ("Autoriteti Kontraktor");

- iii. Autorizimi i Z. Valon Lluka, duke përfshirë, sipas rastit, si përfaqësues i disa palëve (Doppel-/Mehrfachvertretung) dhe vetë-kontraktimi (Selbstkontrahieren), të kryejë të gjitha veprimet për nënshkrimin e marrëveshjeve sipas pikës i) të këtij Vendimi

passport number X4316021, is authorized to participate in the meeting of the General Assembly of Shareholders of the company VIA, a limited liability company, created and existing according to Albanian legislation, registered in the Commercial Registry of Albania, with unique identification number NUIS M118090021, where the Company owns 98% of its capital, to be decided in relation to the agenda as follows:

- i. Approval for the conclusion and implementation of: (i) Loan Agreement; (ii) Cooperation Agreement, (iii) Securing Charge Agreement on Receivables and (iv) Direct Agreement, which will be signed (inter alia) between VIA and the company **Banka Kombëtare Tregtare sh.a.**, a joint-stock company, registered with the Trade Register with unique identification number (NIPT) J62001011Q;

ii. Approval for the correct implementation of all rights and obligations arising from the above-mentioned agreements and aimed at financing the construction activities of Vlorë International Airport in accordance with the concession contract/PPP "For the design, construction, operation, the maintenance and transfer of Vlorë International Airport connected between the merger of the companies Mabco Constructions SA, YDA INSAAT SANAYI VE TICARET ANONIM SIRKETI and 2A GROUP Sh.p.k., as the "Bidder" and the Ministry of Infrastructure and Energy ("Contracting Authority");

- iii. The authorization of Mr. Valon Lluka, including, as the case may be, as representative of several parties (Doppel-/Mehrfachvertretung) and self-dealing (Selbstkontrahieren), to perform all actions for signing agreements according to point i)

<p>ne emër dhe për llogari të VLORA INTERNATIONAL AIRPORT - VIA Sh.P.K. dhe dokumenteve të tjera të kërkuara si dhe përfaqësimin para palëve të treta private ose publike si dhe kryerjen e veprime të tjera që nuk parashikohen shprehimisht këtu, e të cilat do të jenë të nevojshme për formalizimin e marrëveshjeve të lartëçekura dhe për hyrjen e tyre në fuqi.</p> <p>6. Autorizohet Kryetari i Bordit të Drejtorëve të Shoqërisë Z. Emin Pacolli, i lindur më 01.06.1972, në Marec, rezident në Pambio Noranco, mbajtës i pasaportës me numër X4316021, për të nënshkruar dhe lëshuar këtë Vendim me shkrim në emër të Bordit të Drejtorëve.</p> <p>7. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.</p> <p>8. Duke qenë se nuk u ngritën çështje të tjera për diskutim, takimi u shpall i mbyllur.</p>	<p>of this Resolution in the name and on behalf of VLORA INTERNATIONAL AIRPORT - VIA Sh.P.K. and other required documents as well as representation before private or public third parties as well as performing other actions that are not expressly provided for here, and which will be necessary for the formalization of the aforementioned agreements and for their entry into force.</p> <p>6. The Chairman of the Board of Directors of the Company, Mr. Emin Pacolli, born on 01.06.1972, in Marec, resident in Pambio Noranco, holder of passport number X4316021, has the necessary authority and power to sign and issue this Resolution in writing on behalf of the Board of Directors.</p> <p>7. This resolution enters into effect on the day of signing.</p> <p>8. Since no other issues were raised for discussion, the meeting was declared closed.</p>
---	---

On behalf of the Members of the Board of Directors of Mabco Constructions SA

Në emër të Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Mabco Constructions SA

Mr/Z. Emin Pacolli

Chairman of the Board of Directors / President i Bordit të Drejtorëve

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER EDLIRA O. MALAJ(GALANXHI)



DATE 23/03/2023
NR REP 1018

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 23.03.2023, para meje Notere EDLIRA O. MALAJ(GALANXHI), anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, RR.SAMI FRASHERI, PALLATI BLU PERBALLE GJIMNAZIT PETRO NINI LUARASI ,KATI 2, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT:

Behgjet Pacolli, shtetas Kosovar, lindur në Marec dhe banues në adresë Fshati Hajvali, Prishtine, lindur më 30/08/1951, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Nr. X9276840, *ne cilesine e aksionarit te 100 % te kapitalit te regjistruar te shoqërise Mabco Constructions SA.*

Subjekti i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, “Vendim i Kuvendit te Mabco Constructions SA, date 17.03.2023”, bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005, vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

EDLIRA O. MALAJ(GALANXHI)

